



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:005887
Datë: 27.05.2024
Numri i dokumentit: 05735566

K.Dh.Shk.II.nr.471/24

GJYKATA KOMERCIALE – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Premium Bau” sh.p.k, me seli në Prishtinë, Rruga “Raif Paollomi”, Blloku C7, p.n, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arbër Shala, avokat në Prishtinë, kundër debitorit “Alko-Impex-General Construction” sh.p.k, me seli në Prishtinë, Rruga “Ndue Përllëshi”, p.n, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” sh.p.k, me seli në Prishtinë, Soliteri Avalla 2, P+12, për shkak të borxhit sipas dokumentit të besueshëm - faturës, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1772/22, të datën 24.11.2023, me datën 24.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e kreditorit “Premium Bau” sh.p.k, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1772/22 i datën 24.11.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.1772/22 të datën 24.11.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Alko-Impex-General Construction” sh.p.k, ashtu që e ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.808/21 të datës 22.12.2021 të Përmbartuesit Privat Irfan I. Kërçagu, dhe e ka përfunduar në tërësi çështjen përmbartimore.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës përmbartimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit si e bazuar, dhe të anulohet aktvendimi KPPP.nr.1772/22 i datën 24.11.2023 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, ashtu që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar, dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbartimor P.nr.808/21 i datës 22.12.2021 i Përmbartuesit Privat Irfan I. Kërçagu, ose të anulohet aktvendimi i lartcekur dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Debitori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore në ankesë dhe plotësim të saj, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Përmbartuesi Privat Irfan I. Kërçagu, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Premium Bau” sh.p.k, me seli në Prishtinë, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.808/21 të datës 22.12.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturës nr.2020-SHV01-001-25 të datës 05.11.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që kreditorit t’ia paguajë shumën prej 176,749.54 € (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e dyzetë e nëntë euro e pesëdhjetë e katër cent), me kamatë ligjore prej 8 % nga data 23.11.2020, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori përmes të autorizuarit të tij, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se fatura e lartcekur nuk është e përshtatshme për përmbartim dhe ndaj të njëjtës nuk mund të zhvillohet procedurë përmbartimore, sepse e njëjta jo vetëm që nuk është pranuar nga debitori, por edhe është kundërshtuar ngase nuk është as e nënshkruar e as e vulosur nga debitori .

dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi nuk është i përshtatshëm për përmbartim pasi që faturat janë në gjuhë të huaj dhe të njëjtat nuk janë të përkthyer në njërin nga gjuhët zyrtare, dhe se dokumentet në fjalë nuk përbëjnë dokumente të besueshme në kuptim të nenit 11 të LPP-së pasi që janë lëshuar nga një kompani private e shtetit tjetër, ndërsa Republika e Kosovës nuk ka marrëveshje. Me propozim që të aprovohet Prapësimi dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.808/21 i datës 22.11.2021 të shfuqizohet.

Përgjigje në prapësim ka parashtruar kreditori duke theksuar se prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe i njëjti është paraqitur vetëm me qëllim të zvarritjes së procedurës përmbartimore, për faktin se kreditori ka kryer punë për debitorin sipas marrëveshjes dhe fatura e dërguar nga ana e kreditorit është e rregullt, pasi që e njëjta është dërguar përmes postës elektronike e-mailit, dhe të njëjtën debitori e ka pranuar me datën 23.11.2020, andaj, pretendimi se fatura nuk është pranuar nga ana e debitorit është i pa bazuar. Me propozim që Prapësimi i debitorit të refuzohet si i pa bazuar.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP.nr.1772/22, të datën 24.11.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Alko-Impex-General Construction” sh.p.k, ashtu që e ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.808/21 të datës 22.12.2021, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parapara me nenin 182 par.2 të LPK, për arsye se i njëjti është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, e të

cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Sa i përket pretendimeve për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka pranuar prapësimin e debitorit dhe e ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.808/21 të datës 22.12.2021. Gjykata e shkallës së parë, me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ka konstatuar drejtë faktin se dokumenti i besueshëm-fatura, në bazë të cilit organi përmbarues ka caktuar përmbarimin, nuk i plotëson tiparet e përmbarueshmërisë.

Me nenin 29 par.1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP-së) është paraparë se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*. Andaj, në këtë rast nga shkresat e lëndës rezulton se fatura nr.2020-SHV01-001-25 e datës 05.11.2020, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për arsye se edhe pse është dorëzuar përmes e-mailit, e njëjta është kundërshtuar nga ana e debitorit, që do të thotë se debitori të njëjtën nuk e ka pranuar dhe nuk është pajtuar me përmbajtjen e saj. Prandaj, fatura e lartcekur nuk mund të shërbejë si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë.

Bazuar në dispozitat e lartcekura, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka pranuar prapësimin me arsyet se urdhri për përmbarim është lejuar mbi bazën e faturës e cila nuk është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, ngase e njëjta nuk është e nënshkruar nga debitori dhe nuk përmban as vulën e pranimit të debitorit.

Së këndejmi, Gjykata gjen se urdhri për përmbarim i caktuar nga përmbaruesi privat është lëshuar në bazë të një propozimi për përmbarim i cili nuk i ka plotësuar kushtet që kërkohen me nenin 39 të LPP-së.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i vlerësoi të gjitha pretendimet ankimore të kreditorit por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala kreditore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala debitor ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi me rastin e mos kryerjes së përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë, të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore. Andaj, me të drejtë gjykata e shkallës

se parë e ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe e ka anuluar Urdhrin Përmbarimor P.nr.808/21 të datës 22.12.2021 të Përmbaruesit Privat Irfan I. Kërçagu, dhe ka përfunduar në tërësi përmbarimin në këtë çështje përmbarimore.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
K.Dh.Shk.II.nr.471/24, me datë 24.05.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi